



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

RAPORT MBI AKTIVITETIN E KI 2025



10 VITE
Dialog i Strukturuar
Publik-Privat

www.investment.com.al

Këshilli i Investimeve (KI) ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. KI kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që nxisin mirëfunksionimin e tregut.

KI kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje përfaqësues të qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve për zhvillim.

KI mbështetet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).

PËRMBAJTJA

Hyrje	6
Klima e Investimeve	10
Mbledhje e Këshillit të Investimeve	12
Konsultime Teknike	14
10 vite Këshilli i Investimeve	16
Rekomandime të Përmbushura gjatë vitit 2025	18
Forcimi i Zbatimit të Reformave	20
Angazhimi i Partnerëve	21
Avokim dhe Ndërgjegjësim	22
Anketat e KI gjatë 2025	24
Kuadri i Ri i Inspektimeve në Shqipëri: Udhëzues Ligjor dhe Rregullator për Biznesin	25
Komunikim dhe Vizibilitet	26
Planet për të ardhmen	27



Është kënaqësi të rikthehem në drejtimin e Këshillit të Investimeve dhe të vijoj dialogun me përfaqësuesit e biznesit dhe institucioneve në një periudhë që pritet të jetë sfiduese për ekonominë shqiptare. Viti që kemi përpara do të kërkojë më shumë komunikim, bashkëpunim dhe koordinim mes të gjitha palëve, veçanërisht në funksion të zbatimit të ligjeve, standardeve dhe kërkesave të reja që lidhen me zhvillimin ekonomik dhe klimën e biznesit.

Këto procese përbëjnë një sfidë të rëndësishme për biznesin shqiptar dhe për ekonominë në tërësi, por njëkohësisht paraqesin edhe një mundësi të madhe për zhvillim. Në këtë drejtim, puna kërkimore, anketimet dhe rekomandimet e Këshillit të Investimeve kanë një rol thelbësor për të kuptuar më mirë sfidat ekzistuese dhe për të identifikuar mënyrat se si mund të punojmë së bashku për t'i adresuar ato në mënyrë efektive.

Znj. Delina Ibrahimaj
Kryetare e Këshillit të Investimeve
 Ministër i Ekonomisë dhe Inovacionit
 4 dhjetor 2025

OBJEKTIVAT E VEPRIMTARISË GJATË VITIT 2025

Në përputhje me misionin e Këshillit të Investimeve (KI) për forcimin e dialogut publik–privat dhe mbështetjen e reformave të bazuara në evidencë për përmirësimin e klimës së investimeve, veprimtaria e Sekretariatit gjatë vitit 2025 u fokusua në këto shtylla kryesore:

PËRAFRIMI I AGJENDËS SË KI ME PRIORITETET E KLIMËS SË INVESTIMEVE DHE INTEGRIMIN NË BE

Agjendë e orientuar drejt prioriteteve strategjike të klimës së investimeve dhe procesit të integrimit evropian, përmes një qasjeje sistematike konsultimi dhe analize të bazuar në të dhëna, me fokus në digjitalizimin e shërbimeve vendore për biznesin dhe përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes.

Forcimi i bashkëpunimit midis pushtetit vendor dhe sektorit privat në fushën e digjitalizimit të shërbimeve vendore
 Përfshirje e përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe të komunitetit të biznesit nëpër rrethe në proceset e KI-së, duke zgjeruar modelin e

konsultimit në nivel lokal dhe stimuluar një përfaqësim më të gjerë, më gjithëpërfshirës dhe më të balancuar në dialogun publik–privat.

Konsolidimi i dialogut të strukturuar dhe të bazuar në evidenca që lidhen me proceset integruese të vendit
 Dialog përmes integrimit të analizave, të dhënave nga biznesi dhe konsultimeve të strukturuar që diskutimet dhe produktet e KI të mbështeten në evidencë dhe të orientohen drejt zgjidhjeve praktike në fusha kyçe të zhvillimit ekonomik.

AVOKIMI I REKOMANDIMEVE DHE ZGJERIMI I DIALOGUT ME PARTNERËT

Promovim i zbatimit të rekomandimeve të KI

në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përmes angazhimit të vazhdueshëm me institucionet e BE-së, partnerët e zhvillimit dhe aktorët e sektorit privat, duke forcuar rolin e KI si platformë referuese për reforma të klimës së investimeve.

MONITORIMI I PROGRESIT DHE FORCIMI I TRANSPARENCËS INSTITUCIONALE

Përditësim i vazhdueshëm i bazës së të dhënave në sistemin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të KI-së, si dhe raportim i progresit, me synim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies institucionale në procesin e reformave.

HYRJE

Raporti Vjetor 2025 i Këshillit të Investimeve (KI) përkon me një vit me rëndësi të veçantë institucionale, duke shënuar **10 vjet** nga krijimi i Këshillit dhe një dekadë angazhimi në promovimin e dialogut të strukturuar publik–privat në Shqipëri. Gjatë kësaj periudhe, KI është konsoliduar si një platformë trepalëshe ndërmjet qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë, duke kontribuar në mënyrë të qëndrueshme në përmirësimin e klimës së investimeve dhe në avancimin e reformave të bazuara në evidencë.

Gjatë vitit 2025, në një kontekst reformash të intensifikuara, progresi në procesin e integritit evropian dhe kërkesave në rritje për përafrim me standardet e Tregut Unik të BE-së, KI ka ruajtur rolin e tij si mekanizëm dialogu dhe koordinimi të politikave publike. Përmes angazhimit me institucionet publike, biznesin dhe partnerët për zhvillim, Këshilli ka mbështetur identifikimin e prioritetëve të reformave dhe formulimin e rekomandimeve të bazuara në evidencë dhe konsultime gjithëpërfshirëse. Pavarësisht dinamikës më të kufizuar të mbledhjeve plenare gjatë këtij viti, për shkak të zhvillimeve të rëndësishme politike, përfshirë zgjedhjet parlamentare, angazhimi i palëve të interesit është ruajtur përmes konsultimeve teknike, analizave tematike dhe dialogut të strukturuar. Në këtë kuadër, KI ka ruajtur funksionin e tij monitorues dhe analitik, duke mbështetur transparencën dhe llogaridhënien në procesin e politikëbërjes.

NGJARJET KRYESORE


Veprimtaria e KI gjatë vitit 2025 u fokusua në digjitalizimin e shërbimeve publike në nivel vendor dhe rritjen e ndërgjegjësimin të biznesit mbi kërkesat që burojnë nga Plani i Rritjes dhe Agjenda e Reformave e

BE-së. U zhvilluan një mbledhje plenare dhe shtatë tryeza teknike, me pjesëmarrjen e aktorëve nga biznesi dhe institucionet publike, duke gjeneruar rekomandime për përmirësimin e shërbimeve digjitale për biznesin.


Bashkëpunimi me nivelin vendor u zgjerua përmes angazhimit me disa bashki, duke forcuar dimensionin lokal të dialogut mbi investimet dhe zhvillimin ekonomik. Paralelisht, u forcua angazhimi në procesin e integritit evropian dhe në Planin e Rritjes përmes pjesëmarrjes në forume të nivelit të lartë dhe platforma rajonale e evropiane, përfshirë CEI dhe SEECP, si edhe ndërtimit të evidencave specifike në këtë drejtim.

Në fushën e përputhshmërisë rregullatore, në bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (IDP) dhe Autoritetin Kombëtar të Konkurrencës, u zhvilluan aktivitete ndërgjegjëse, respektivisht mbi GDPR-në dhe çështjet e konkurrencës. Sekretariati i KI u emërua gjithashtu vëzhgues nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit (SASPAC) në Platformën Kombëtare të Monitorimit të Planit të Rritjes, duke forcuar rolin e tij institucional në ndjekjen e reformave.

Gjatë vitit, puna analitike u mbështet nga 6 analiza teknike dhe 2 anketa kombëtare me 351 kompani, duke mundësuar formulimin e rekomandimeve të Këshillit të bazuara në gjithëpërfshirje dhe evidencë. Në dhjetor 2025, Sekretariati i KI u vlerësua në CCIT Awards nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë për kontributin në promovimin e reformave dhe përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri, ndërsa përvjetori i 10-të i Këshillit u festua në një aktivitet të nivelit të lartë me pjesëmarrjen e aktorëve institucionalë, përfaqësuesve të biznesit dhe partnerëve ndërkombëtarë.



KALENDARI I AKTIVITETEVE KRYESORE gjatë vitit 2025



KLIMA E INVESTIMEVE

Ekonomia shqiptare vijoi të shfaqë rritje pozitive gjatë vitit 2025, me Produktin e Brendshëm Bruto që u **rrit me 3,79%**, duke reflek-tuar qëndrueshmëri të aktivitetit ekonomik dhe kërkesës së brendshme. Inflacioni mesatar u mbajt në nivelin **2,2%**, duke sinjalizuar stabi-litet të përgjithshëm të çmi-meve, ndërsa tregu i punës regjistroi përmirësim gradu-al, me papunësinë në nivelin 8,3% në tremujorin e katërt të vitit.

Flukset hyrëse të Investi-meve të Huaja Direkte arri-tën në **1,63 miliardë euro**, ndërsa stoku total u rrit me rreth 10%, duke arri-tur në **16,99 miliardë euro**. Flukset e investi-meve vijuan të përqendro-hen kryesisht në pasuritë e paluajtshme, ndërsa vendet kryesore investuese mbetën Holanda, Italia dhe Kosova. Viti 2025 u karakterizua gjithashtu nga zgjedhjet parlamentare, si një zhvillim i rëndësishëm politik, i cili ndikoi në dinamikën e agjendës institucionale dhe në zhvillimin e procesit konsultativ.


Flukset hyrëse të Investimeve të Huaja Direkte arritën në **1,63 miliardë euro**, ndërsa stoku total u rrit me rreth 10%, duke arritur në **16,99 miliardë euro**.

Në planin fiskal, buxheti i vitit 2025 u orientua drejt ruajtjes së disiplinës fiskale dhe mbështetjes së investimeve publike, në funksion të rritjes ekonomike dhe stabilitetit makroekonomik.

Në kuadër të integritimit evropian, Shqipëria vijoi progresin në zbatimin e Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian, i shoqëruar me disbursimin e 99.3 milionë eurove në mbështetje të reformave prioritare. Paralelisht, u vijua puna për përafrimin me acquis të BE-së, përfshirë avancimin e kuadrit të ri ligjor për inspektimet dhe forcimin e mekanizmave rregullatorë.

Në planin institucional, krijimi i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) konsolidoi fokusin në politikat e inovacionit dhe digjitalizimit. Në të njëjtën kohë,

u propozua një kuadër për shqyrtimin e investimeve të huaja në sektorë të ndjeshëm, mbi baza të sigurisë kombëtare dhe rendit publik, ndërsa disa masa fiskale dhe rregullatore gjeneruan diskutime në lidhje me ndikimin e tyre në klimën e biznesit dhe konkurrencën.



MBLEDHJE E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE



MBI DIGJITALIZIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE VENDORE PËR BIZNESIN

Transformimi digjital i shërbimeve administrative mbetet një proces kompleks, veçanërisht në nivel vendor, ku panorama paraqitet e fragmentuar dhe e karakterizuar nga kapacitete të ndryshme në burime njerëzore, teknologji, infrastrukturë dhe organizim institucional. Ndërkohë që qeveria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në avancimin e digjitalizimit në nivel kombëtar dhe lokal, potenciali i plotë i këtij procesi varet edhe nga angazhimi i aktorëve të tjerë, përfshirë sektorin privat si një partner kyç.

Diskutimi u fokusua në eksperiencat dhe sfidat aktuale të bizneseve, si dhe në pritshmëritë e tyre ndaj shërbimeve digjitale vendore. Në veçanti, u trajtuan: (i) barra administrative dhe raporti kosto-përfitim në aksesin e shërbimeve publike, (ii) identifikimi i shërbimeve prioritare për digjitalizim në nivel vendor, dhe (iii) forcimi i komunikimit fiskal dhe transparencës, përfshirë mekanizmat e njoftimit dhe ankimit, si dhe përmirësimin e procedurave të lejeve elektronike.

REKOMANDIME KRYESORE

- **Autoritetet e qeverisjes vendore** duhet të përcaktojnë objektiva dhe tregues të qartë performance për shërbimet ndaj biznesit, duke integruar cilësinë e shërbimeve digjitale në planifikimin strategjik, buxhetor dhe operacional, si dhe në sistemet e monitorimit dhe raportimit.
- **Të sigurohet një tranzicion gradual dhe i mirëkoordinuar** drejt digjitalizimit të shërbimeve vendore, i shoqëruar me sportele fizike mbështetëse për bizneset e vogla. Në fazën fillestare, prioritet duhet t'u jepet shërbimeve bazë online, përfshirë informacionin, deklaratimet, regjistrimet, pagesat, ankimet dhe vërtetimet, si dhe integrimi i tyre me platformën e-Albania.
- **Procesi i digjitalizimit në nivel vendor** duhet të mbështetet në një kornizë të qartë rregullatore, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale, standardet e sigurisë kibernetike dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe etike në fuqi.
- **Të forcohen mekanizmat mbështetës për transformimin digjital të biznesit**, veçanërisht për NVM-të, përmes një roli më aktiv të dhomave të tregtisë dhe shoqatave të biznesit në partneritet me autoritetet vendore, duke nxitur përdorimin e platformave si e-Albania dhe reduktimin e barrës administrative dhe burokratike.

“Digjitalizimi dhe komunikimi i qeverisjes vendore me biznesin duhet të jenë efektivë, të zbatueshëm dhe me impakt të matshëm, përfshirë një analizë të qartë kosto-përfitim. Pavarësisht progresit të arritur, një pjesë e shërbimeve mbeten të paplota ose të fragmentuara, duke theksuar nevojën për forcim të kapaciteteve, trajnim të stafit dhe rritje të përgjegjshmërisë në menaxhimin e sistemeve. Gjithashtu, nevojitet më shumë transparencë dhe qartësi në zbatimin e taksave vendore, si dhe një qasje më strategjike ndaj zhvillimit ekonomik lokal. Proceset e reformës dhe digjitalizimit duhet të prodhojnë përmirësime konkrete dhe të matshme për bizneset dhe qytetarët.”

KONSULTIME TEKNIKE



Takime konsultative mbi sfidat e biznesit në nivel vendor

Në kuadër të përgatitjeve për mbledhjen e ardhshme të KI, Sekretariati zhvilloi konsultime me përfaqësues të biznesit dhe pushtetit vendor në bashkitë Tiranë, Elbasan, Korçë, Kolonjë, Durrës dhe Lushnjë. Diskutimet u fokusuan në sfidat e ofrimit të shërbimeve administrative në nivel lokal, duke përfshirë nevojën për përshtetjen e digjitalizimit, përdorimin më të gjerë të platformave elektronike për reduktimin e burokracisë, përvojat me shërbimet ekzistuese (përfshirë sportelet me një ndalesë dhe e-lejet), gatishmërinë për tranzicionin digjital dhe forcimin e transparencës në ndërveprimin biznes-bashki.

Tryezë diskutimi mbi Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Në bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (IDP) dhe Shoqatën e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA), Sekretariati organizoi një konsultim me mbi 40 përfaqësues të sektorit privat mbi Ligjin nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Takimi u fokusua në rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat dhe detyrimet ligjore, si dhe në identifikimin e sfidave praktike të zbatimit. U theksua nevoja për forcim të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe mbështetje teknike për përshtatjen me kuadrin e ri ligjor dhe standardet e BE-së.

Promovimi i kulturës së konkurrencës: manuale për shoqatat e biznesit

Autoriteti i Konkurrencës dhe UNCTAD, në bashkëpunim me Sekretariatit e KI, prezantuan manualin e reja për përputhshmërinë me ligjin e konkurrencës për shoqatat e biznesit. Sesioni “Nga Rreziku tek Mundësitë: Përputhshmëria për Shoqatat e Biznesit” u moderua nga Drejtoresha e Sekretariatit, Dr. Diana Leka (Angoni), me pjesëmarrjen e ekspertëve ndërkombëtarë dhe përfaqësuesve të biznesit. Diskutimet nënvizuan rëndësinë e integritetit, transparencës dhe përgatitjes së ndërmarrjeve për konkurrencën në Tregun e Përbashkët. Manuali, i zhvilluar nga UNCTAD me mbështetjen e BERZH dhe SECO, ofron udhëzime praktike për zbatimin e programeve të përputhshmërisë.

10 VITE KËSHILLI I INVESTIMEVE

Një dekadë bashkëpunimi
për përmirësimin e
klimes së biznesit

22 tetor 2025

Këshilli i Investimeve festoi 10-vjetorin e krijimit në një aktivitet të nivelit të lartë me pjesëmarrjen e rreth 100 përfaqësuesve nga qeveria, parlamenti, sektori privat dhe partnerët ndërkombëtarë. Aktiviteti shërbeu si një moment reflektimi mbi një dekadë dialogu të strukturuar publik–privat dhe kontributin e KI në përmirësimin e klimes së biznesit përmes mbi 350 rekomandimeve, të cilat kanë mbështetur reforma në fusha kyçe.

Përfaqësues të qeverisë, BERZH-it, Ambasadës së Zvicrës dhe komunitetit të biznesit vlerësuan rolin e KI si një platformë të besueshme dialogu dhe bashkëpunimi, duke theksuar kontributin e tij në avancimin e reformave dhe në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë.



Këshilli i Investimeve
– Video Dokumentari, 10-Vjet Dialog
Publik-Privat



Këshilli i Investimeve
– Festimi i 10-vjetorit, 22 tetor 2025



Foto Album i Festimit të 10-vjetorit



REKOMANDIME TË PËRMBUSHURA GJATË VITIT 2025

Që prej krijimit në vitin 2015, KI ka miratuar **357 rekomandime** për përmirësimin e klimës së investimeve në Shqipëri. Monitorimi i tyre tregon një progres të moderuar në zbatim, me ndikim të dukshëm në disa fusha reformash, ndërsa sfidat strukturore dhe institucionale mbeten ende të pranishme.

STATUSI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE (2015-2025)



FUSHAT KRYESORE TË NDIKIMIT GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025, progresi më i dukshëm është evidentuar në aksesin në financë për NMVM-të, ku janë zgjeruar instrumentet mbështetëse përmes skemave të garancisë dhe bashkëpunimit me institucione financiare ndërkombëtare, duke përmirësuar aksesin në kredi, megjithëse përfshirja e grave sipërmarrëse mbetet ende e kufizuar.

Në fushën e inovacionit dhe digjitalizimit, janë hedhur hapa drejt konsolidimit të ekosistemit mbështetës për NMVM-të, përfshirë zhvillimin e mekanizmave të rinj si Qendrat Evropiane të Inovacionit Digjital, ndërsa nevojitet forcim i mëtejshëm institucional dhe financiar për të rritur efikasitetin e tyre.

Sa i përket tregtisë dhe ndërkombëtarizimit, janë shënuar zhvillime në kuadrin fiskal dhe në digjitalizimin e pagesave, me rritje të përdorimit të instrumenteve elektronike dhe përmirësim të formalizimit në disa segmente të ekonomisë. Paralelisht, është avancuar kuadri strategjik për mbështetjen e eksportuesve, përfshirë programet e reja dhe platformën Export Albania, ndërsa sfidat mbeten në kapacitetet certifikuese dhe infrastrukturën teknike.

Në sektorin financiar, zhvillimi i bankut digjital dhe hapja e tregut për shërbime të reja, përfshirë licencimin e parë të një institucioni të Open Banking, përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt rritjes së konkurrencës dhe përfshirjes financiare.

Në fushën e pronësisë dhe kadastrës, është vijuar me zbatimin e udhërrëfyesit të digjitalizimit dhe zgjerimin e shërbimeve online përmes platformës e-Albania, duke përmirësuar transparencën dhe sigurinë juridike, megjithëse procesi i reformës mbetet ende në zhvillim.

Në vitin 2025, 24 rekomandime janë marrë në konsideratë, prej të cilave 15 janë konsideruar të zbatuara dhe 9 janë në fazë fillestare zbatimi. Megjithatë, sfida të vazhdueshme në procesin e monitorimit mbeten raportimi e transparenca nga institucionet publike dhe matja e ndikimit të politikave e strategjive të ndërmarra.

Në tërësi, rreth 114 rekomandime mbeten ende të pazbatuara, veçanërisht në fusha strukturore si informaliteti, pronësia dhe koordinimi institucional, duke theksuar nevojën për përshejtim të zbatimit dhe forcim të bashkëpunimit ndërinstitucional.



Kliko për më shumë informacion.

FORCIMI I ZBATIMIT TË REFORMAVE

Zbatimi i rekomandimeve të KI është lehtësuar dhe forcuar në sajë të mbështetjes me projekte vijuese nën drejtimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe mbështetjes së Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).

Një prej iniciativave ka qenë mbështetja e strukturuar në dy komponentë: forcimi i kapaciteteve avokuese të shoqatave dhe dhomave të biznesit, si dhe zhvillimi i aftësive për ndërkombëtarizimin e NVM-ve. Në kuadër të komponentit të parë, u realizuan intervista dhe anketa me 20 shoqata biznesi dhe dhoma tregtie, si dhe u përgatit një Raport

Vlerësimi i Nevojave për forcimin e kapaciteteve të tyre. Më tej, u zhvilluan tre sesione workshop-i mbi teknikat e avokimit të politikave me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga tetë dhoma tregtie dhe shoqata biznesi; dy seri workshop-esh mbi navigimin e politikave publike; paketa komunikimi për shoqatat e biznesit; dy module trajnuese; si dhe tre sesione “Trajnim për trajnerët” me fokus ndërkombëtarizimin e NVM-ve.



European Bank
for Reconstruction and Development



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

State Secretariat for Economic Affairs SECO



Albania
Investment
Council
Improving Transparency and Investment Climate

ANGAZHIMI I PARTNERËVE



102

përfaqësues të biznesit
morën pjesë në mbledhje të KI dhe mbledhje teknike.

1

1 mbledhje e nivelit të lartë e KI-së, e drejtuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit, me pjesëmarrjen e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe **79% pjesëmarrje** të anëtarëve

2

anketa me **351 kompani** – 23% me administratore gra

7

fokus grupe me 57 pjesëmarrës nga qeverisja lokale, biznesi dhe ekspertë të pavarur

Përfaqësimi gjinor:

62% **38%**
gra burra

Gjatë vitit 2025, angazhimi i partnerëve në kuadër të Këshillit të Investimeve u ruajt në nivele të qëndrueshme, duke reflektuar pjesëmarrje të gjerë dhe të strukturuar të sektorit privat, institucioneve publike dhe ekspertëve në procesin konsultativ dhe teknik.

Rrjeti i shoqatave dhe dhomave të biznesit në KI përfaqëson aktualisht interesat e rreth **1,250**

kompanive. Gjatë vitit, agjenda e KI u zgjerua përmes bashkëpunimeve me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (IDP), Autoritetin e Konkurrencës dhe UNCTAD, duke përfshirë tema të reja si mbrojtja e të dhënave personale dhe përputhshmëria me rregullat e konkurrencës (manual për shoqatat e biznesit), përtej prioriteteve të miratuara nga KI për vitin 2025.

AVOKIM DHE NDËRGJEGJËSIM

Bashkëpunimi me akademinë – Konkursi “Tung Ideas” (Universiteti Epoka)

28 SHKURT 2025

Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me Universitetin Epoka që prej vitit 2017, Sekretariati i KI mori pjesë si anëtar jurie në konkursin “Tung Ideas 2025”. Studentët nga institucione të ndryshme prezantuan ide inovative dhe konkurruan për çmimin “Startup-i më i mirë”. Aktiviteti shërbeu si platformë për nxitjen e sipërmarrjes rinore dhe inovacionit, si dhe për promovimin e qasjeve të KI për forcimin e ekosistemit të inovacionit përmes bashkëpunimit ndërmjet akademisë, sektorit privat dhe institucioneve publike.

Kontribut në Takimin Rajonal “Tregu i Përbashkët Rajonal – Një Rrugë e Përsheptuar drejt Integritimit Ekonomik Evropian”

26 MARS 2025

Në kuadër të Takimit Rajonal “Tregu i Përbashkët Rajonal – Një Rrugë e Përsheptuar drejt Integritimit Ekonomik Evropian”, organizuar nga MEKI në kuadër të kryesimit të Shqipërisë të SEECP, Drejtuesja e Sekretariatit të KI kontribuoi në panelin e diskutimit mbi sfidat e biznesit në procesin e integritimit evropian, duke theksuar nevojën për mbështetje të sektorëve me potencial eksportues, harmonizim me standardet e BE-së dhe politika që forcojnë cilësinë, konkurrueshmërinë dhe ndërgjegjësimin e sipërmarrësve për kërkesat e legjislacionit evropian.

Sekretariati i KI në një prezantim mbi klimën e biznesit me sektorin privat zviceran

17 QERSHOR 2025

Me ftesë të Ambasadës Zvicerane dhe në një aktivitet të organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë (SWISSA), Sekretariati i KI prezantoi sfidat kryesore të klimës së biznesit në Shqipëri, bazuar në analizat

e tij mbi çështje të ndryshme që ndikojnë sektorin privat. Aktiviteti mbledhi sipërmarrës dhe profesionistë nga komunitetet zvicerane dhe shqiptare, duke ofruar një platformë për shkëmbim të ideve dhe nxitje të bashkëpunimeve të reja.

Vizitë studimore në Bruksel: Përfshirja dhe transparenca në procesin e reformave

23-24 QERSHOR 2025

Si pjesë e një vizite studimore të organizuar nga Instituti për Dialog dhe Integritim (CDI), Sekretariati mori pjesë në një sërë takimesh në Bruksel me institucione të BE-së dhe përfaqësues të shoqërisë civile, përfshirë DG ENEST, Parlamentin Evropian, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian (EESC) dhe Misionin Shqiptar në BE, mbi Axtendën e Reformave dhe Instrumentin e Reformës dhe Rritjes. Në këto takime, Sekretariati prezantoi rolin e KI si platformë trepalëshe për dialog ndërmjet qeverisë, biznesit dhe shoqërisë civile, duke theksuar rëndësinë e transparencës dhe përfshirjes së aktorëve në monitorimin e reformave në kuadër të Planit të Rritjes.

Kontribut në dialogun mbi aftësitë e të rinjve dhe gatishmërinë për tregun e punës në kuadër të integritimit evropian

2 KORRIK 2025

Në kuadër të edicionit të dytë të Javës së Administratës Publike 2025, Sekretariati i KI mori pjesë në aktivitetin “Në Zemër të Integritimit: Një Takim me Negociatorët”, organizuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Gjatë diskutimit, Drejtuesja e Sekretariatit theksoi rëndësinë e përgatitjes së të rinjve për kërkesat e tregut evropian të punës, nevojën për zhvillimin e aftësive të reja në përputhje me transformimin digjital dhe procesin e integritimit, si dhe domosdoshmërinë e monitorimit të nevojave të tregut të punës për të adresuar mungesat në aftësi. Duke iu referuar analizave të KI, u nënvizua se mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar mbetet një nga shqetësimet kryesore të biznesit,



ndërsa u theksua nevoja për përfshirje më të madhe të të rinjve dhe sipërmarrësve në procesin e integritimit evropian.

Takim me Grupin COELA të Këshillit të Bashkimit Evropian

10 TETOR 2025

Sekretariati i Këshillit të Investimeve kontribuoi në takimin e organizuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë, në kuadër të vizitës së Grupit COELA të Këshillit të BE-së. Gjatë diskutimeve u prezantuan avantazhet konkurruese të Shqipërisë për investime, si pozicioni strategjik, niveli i taksave, burimet natyrore dhe kapitali njerëzor, ndërsa u evidentuan edhe sfida si emigracioni, mungesa e fuqisë punëtore dhe nevoja për përmirësime të mëtejshme në sundimin e ligjit, sigurinë juridike të pronës dhe efikasitetin e proceseve gjyqësore. Takimi shërbeu

gjithashtu për të diskutuar progresin në digjitalizimin e shërbimeve publike dhe ndikimin e reformave në klimën e biznesit.

Vlerësim i Sekretariatit të KI në CCIT Awards 2025

17 DHJETOR 2025

Në ceremoninë CCIT Awards 2025, Sekretariati i KI u vlerësua nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë për kontributin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm në promovimin e reformave dhe iniciativave që mbështesin përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri. Gjatë aktivitetit, u theksua rëndësia e dialogut të strukturuar ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat, si një element kyç për avancimin e reformave ekonomike dhe përgatitjen e biznesit shqiptar për integrimin në Tregun Unik të Bashkimit Evropian.

ANKETAT E KI GJATË 2025



Gjatë vitit 2025, KI vazhdoi angazhimin për të nxitur një dialog të bazuar në evidenca, duke zhvilluar 2 anketa gjithëpërfshirëse me pjesëmarrjen e 351 kompanive. Anketat shërbejnë si një instrument kyç për mbledhjen e perceptimeve dhe përvojave të komunitetit të biznesit, në përputhje me metodologjinë nga poshtë-lart të ndjekur nga KI që prej krijimit të tij në vitin 2015.

Gjetjet u përqendruan në dy fusha kryesore:

Sfidat e ndërveprimit bashki-biznes në ofrimin e shërbimeve – Analizimi i pengesave në shërbimet administrative, digjitalizimin, barrat burokratike, transparencën dhe perceptimet mbi korrupsionin, me synim identifikimin e hapësirave për përmirësim të klimës së biznesit në nivel vendor dhe forcimin e dialogut me pushtetin lokal.

Klima e Investimeve – Evidentimi dhe krahasimi i perceptimeve të biznesit mbi administrimin tatimor, produktivitetin, inovacionin dhe sfidat e NMVM-ve në kuadër të integritetit në Tregun e Përbashkët Evropian, me qëllim identifikimin e prioriteteve për reforma dhe masa mbështetëse. Anketimi mbi klimën e biznesit është një instrument periodik i KI-së që prej vitit 2015, ndërsa këtë vit u përfshi për herë të parë një seksion i dedikuar për ndjeshmërinë e NMVM-ve ndaj procesit të integritetit në BE.



Kliko për më shumë informacion.

KUADRI I RI I INSPEKTIMEVE NË SHQIPËRI

Udhëzues Ligjor dhe Rregullator për Biznesin

Që prej vitit 2016, KI ka adresuar në mënyrë të vazhdueshme sfidat e sistemit të inspektimeve, përfshirë barrat e tepërta administrative dhe financiare për bizneset, si dhe mangësitë në mekanizmat e ankimimit. Kuadri i ri i inspektimeve synon të thjeshtojë proceset e inspektimit, të përafrohet me standardet e Bashkimit Evropian dhe të vendosë një sistem transparent dhe të bazuar në risk, në mbështetje të investimeve vendase dhe të huaja.

Përmbledhja e përgatitur nga Sekretariati ofron udhëzime të strukturuar mbi procedurat e inspektimit, si dhe mbi të drejtat dhe detyrimet e bizneseve, duke mbështetur përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore të miratuara deri më 25 nëntor 2025.



Kliko për më shumë informacion.

KOMUNIKIM DHE VIZIBILITET

FAQJA E INTERNETIT:

- » 36,000 shikime të faqes në 2025

MEDIAT SOCIALE:

- » Aktiv në 3 platforma: Facebook, LinkedIn, X
- » 7.8% rritje në numrin e ndjekësve (5,238 në 2025 vs 4,857 në 2024)

BULETINË TREMUJORË

Shpërndarë në mënyrë elektronike tek të gjithë partnerët e KI-së dhe postuar në mediat sociale.

- » [Janar-Mars 2025](#)
- » [Prill-Qershor 2025](#)
- » [Korrik-Shtator 2025](#)
- » [Tetor-Dhjetor 2025](#)

DOKUMENTE

MATERIALET E MBLEDHJES SË KI

- » Mbledhja XXXVI – Agjenda
- » Mbledhja XXXVI – Prezantim PPT
- » Mbledhja XXXVI – Dokument Pune “Mbi Digjitalizimin e Shërbimeve Publike Vendore për Biznesin”
- » Gjetjet e Vrojtimit – Sfidat e Ndërveprimit Bashki-Biznes në Ofrimin e Shërbimeve
- » Gjetjet e Anketës – Mbi Klimën e Investimeve 2025
- » Mbledhja XXXVI – Matrica e Rekomandimeve
- » Mbledhja XXXVI – Minutat

PREZENCË MEDIATIKE NË KANALET KOMBËTARE TELEVIZIVE

» Scan TV

Planet për mbështetjen e bujqësisë dhe agropërpunimit/Rekomandimet e KI: Të vijojë digjitalizimi – 21 maj 2025

Raport për ndërhyrje kyçe në sektorin e bujqësisë-Këshilli i Investimeve: Nisma të reja për... – 22 nëntor 2025

Siguria me pronat dhe Kadastra Digjitale - Këshilli i Investimeve zbulon pengesën që po largon... – 24 nëntor 2025

(SHPËRNDARJA E LAJMEVE)

- » 1,100 të abonuar
- » Shpërndarë në anglisht dhe shqip

PUBLIKIME

- » Përmbledhje mbi Treguesit Makro-Ekonomikë, 2024
- » Përmbledhje mbi Treguesit Makro-Ekonomikë, Janar-Qershor 2025
- » Raporti i Monitorimit të Rekomandimeve, 2024
- » Raporti i Aktiviteteve, 2024
- » Raportim mbi Progresin e Rekomandimeve të KI (Korrik 2025)
- » Kuadri i Ri i Inspektimit në Shqipëri
- » Broshurë: Kalendari i Arritjeve në 10 Vite
- » Broshurë: 10 Vite në Shifra

PLANET PËR TË ARDHMEN

KI do të vijojë të shërbejë si një platformë e rëndësishme për nxitjen e dialogut konstruktiv ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat, me synim forcimin e besimit të investitorëve, përmirësimin e klimës së biznesit dhe adresimin e sfidave të zhvillimit ekonomik me ndikim afatmesëm dhe afatgjatë. Agjenda e miratuar për vitin 2026 është hartuar mbi bazën e dokumenteve strategjike kryesore të Qeverisë dhe çështjeve të ngritura nga anëtarët e biznesit, duke shërbyer si udhërrëfyes për aktivitetin e KI gjatë vitit 2026. Në këtë kuadër, anëtarët e Këshillit kanë përcaktuar si prioritet çështjen e sigurisë juridike të pronës.



Numra të rëndësishëm 2025

1 MBLEDHJE e KI

7 REKOMANDIME TË MIRATUARA

15 REKOMANDIME TË ZBATUARA, **9** NË PROCES

6 DOKUMENTE ANALITIKE

+20 DHOMA/SHOQATA TË BIZNESIT TË ANGAZHUARA NË AKTIVITETE TË KI

1,250 BIZNESE TË PËRFAQËSUARA NGA DHOMAT/SHOQATAT ANËTARE NË KI

2 VROJTIME

351 KOMPANI PJESËMARRËSE NË VROJTIME

102 BIZNESE PJESËMARRËSE NË MBLEDHJE TË KI, DHE MBLEDHJE TË TJERA TEKNIKE

7 TAKIME FOKUS GROUP

1 RAPORT VJETOR MONITORIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KI

1,100 TË ABONUAR NË FAQEN E KI

79% NIVELI I PJESËMARRJES SË ANËTARËVE NË MBLEDHJE TË KI

5,238 NDJEKËS NË MEDIAT SOCIALE

PJESËMARRJA GJINORE NË AKTIVITETE TË KI: **38%** BURRA **62%** GRA

81 PËRFAQËSUES TË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE PJESËMARRËS NË MBLEDHJE TË KI, DHE MBLEDHJE TË TJERA TEKNIKE

2 TRYEZA/SEMINARE ME PARTNERË TË TJERË

Anëtarë të KI 2025

Anëtarë, Institucione Shtetërore

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

Banka e Shqipërisë

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

Anëtarë, Partnerë për Zhvillim

Banka Botërore

Delegacioni i BE-së në Shqipëri

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)

Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC)

Anëtarë të Biznesit me Mandat të Përhershëm

Dhoma e Industrisë dhe Tregtisë Tiranë

Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare (ADBC)

Anëtarë të Biznesit me Mandat 2-Vjeçar

Shoqata e Investitorë të Huaj në Shqipëri (FIAA)

Shoqata e Bankave (AAB)

Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC Albania)

Dhoma Ekonomike e Gruas (DHEG)

Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham)

Shoqata Shqiptare e Tregtisë Elektronike (AECA)

Confindustria Albania

Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri (HBAA)

Anëtarë të Tjerë të Biznesit

Shoqata Shqiptare e Ndërtuesve

EasyPay

RAPORT MBI AKTIVITETIN E KI 2025



Improving Transparency and Investment Climate

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Stafi

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

Albania Investment Council ALInvestCouncil Albania Investment Council



European Bank
for Reconstruction and Development



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).